



"KOKA & ERGI ENERGY PESHK" SHPK  
K88027901B  
Martanesh, Dibër

**VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË**

**NR. 2, DATË 03.12.2023**

Sot, me datë 03.12.2023 ora 10:00 në selinë e Shoqërisë "KOKA & ERGI ENERGY PESHK" SHPK me numër unik identifikimi K88027901B, u mbajt mbledhja e ortakëve të shoqërisë, e përbëre nga:

1. Shoqëria "KOKA" sh.p.k përfaqësuar nga Z. Rakip Koka, zotërues i 51% të kuotave të kapitalit;
2. Shoqëria "SHIJAKU" sh.p.k përfaqësuar nga Z. Shpëtim Shijaku, zotërues i 46 % i kuotave të kapitalit;
3. Shoqëria "OLSAR-ZELA" sh.p.k përfaqësuar nga Z. Xheladin Zela, zotërues i 3% i kuotave të kapitalit;

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, bazuar në diskutimet e mëparshme dhe në një mirëkuptim në parim të arritur mes ortakëve, mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

**Çështjet e rendit të ditës:**

1. *Zmadhimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë nëpërmjet kontributit në likuiditete të tre ortakëve në vlerën 250,000,000 (dyqind e pesëdhjetë milion) leke, sipas përqindjes në pjesëmarrje që ata kanë në shoqëri.*

Pasi u vertetua prezenca e anëtarëve dhe kuorumi i nevojshëm i Asamblesë së Përgjithshme për të marrë vendime, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendosi:

1. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të regjistruar në shoqërisë në vlerën 250,000,000 (dyqind e pesëdhjetë milion) leke me kontributin në para të tre ortakëve sipas përqindjes në pjesëmarrje që ata kanë në shoqëri.
2. Sijcili nga ortakët e shoqërisë do të kontribojë në likuiditete si më poshtë :
  - Shoqëria « Koka » sh.p.k do të kontribojë me 127,500,000 leke ;
  - Shoqëria « Shijaku » sh.p.k do të kontribojë me 115,000,000 leke
  - Shoqëria « Olsar-Zela » sh.p.k do të kontribojë me 7,500,000 leke
3. Kapitali i regjistruar i shoqërisë « Koka & Ergi Energy Peshk » sh.p.k prej 100,000 (njqind mije) leke, pas shtesës në vlerën prej 250,000,000 (dyqind e pesëdhjetë - million ) leke, shkon në masën prej 250,100,000 (dyqind e pesëdhjetë milion e njqind mije) leke.



"KOKA & ERGI ENERGY PESHK" SHPK  
K88027901B  
Martanesh, Dibër

4. Kapitali i ndryshuar i shoqërisë në vlerën 250,100,000 (dyqind e pesëdhjetë e milion e njëqind mijë) leke ndahet në 3 (tre) kuota në vlerat :
  - Shoqëria « Koka » sh.p.k do të zotërojë kuotën në vlerën 127,551,000 (njëqind e njëzetë e shtatë milion e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë ) leke.
  - Shoqëria « Shijaku » sh.p.k do të zotërojë kuotën në vlerën 115,046,000 (njëqind e pesëmbëdhjetë milion e dyzetë e gjashtë mijë) leke.
  - Shoqëria « Olsar-Zela » sh.p.k do të zotërojë kuotën në vlerën 7,503,000 (shtetë milion e pesëqind e tremijë) leke.
5. Ngarkohet administratori i shoqërisë të ndjekë procedurat për arketimin e shumave nga secila shoqëri si me sipër si edhe për regjistrimin e rritjes së kapitalit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË

"KOKA & ERGI ENERGY PESHK" sh.p.k

ORTAKU

"KOKA" shpk

Z. Rakip Koka



ORTAKU

"SHIJAKU" shpk

Z. Shpëtim Shijaku



ORTAKU

"OLSAR -ZELA" shpk

Z. Xheladin Zela

